



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 17739 Prot.

Lezhë, më 06 . 10 . 2021

VENDIM

Nr. 142 Datë 04 . 10 . 2021

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI
PYJOR BASHKIAK PËR SHFRYTËZIMIN E GURIT GËLQEROR NGA SHOQËRIA
“KOVAÇI-3” NË OBJEKTIN “TRESH”.

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr.8480, date 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020, date 30.04.2020 "Për Pyjet", në Ligjin nr. 10304, date 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433 datë 8.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të fondit pyjor e kullësor publik, ndryshuar me VKM nr 684 datë 02.09.2020", në VKM nr. 591, datë 9.10.2018, "Për disa ndryshime në VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat dhe paraqitjen e kërkesës, mbajtjen e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", në VKM nr.592, date 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr. 1374, date 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor" Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, date 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor bashkiak për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, të sipërfaqes prej 2.5 Ha, në ngastrën 72a në ekonominë pyjore "Molung", të Bashkisë Lezhë, sipas Raportit Tekniko-Ekonomik bashkëlidhur.
2. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore të dëmtuar jashtë pjesës së marrë në përdorim bëhet nga shoqëria "KOVAÇI-3" brenda 1 (një) viti nga koha e përfundimit të objektit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Njësia e Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST BAKAJ

